

VENDIM
Nr. 44/2017

**PËR CAKTIMIN E DEPUTETËVE SILVA CAKA DHE DASHAMIR PEZA ANËTARË
ZËVENDËSUES NË KOMISIONIN PARLAMENTAR AD HOC PËR VERIFIKIMIN E
KANDIDATËVE PËR INSTITUCIONET E RIVLERËSIMIT, SIPAS LIGJIT NR.
84/2016, “PËR RIVLERËSIMIN KALIMTAR TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, NGRITUR ME VENDIMIN E KUVENDIT NR.
41/2017**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, të neneve 21, pika 3 dhe 55 pika 1 të Rregullores së Kuvendit, si dhe nenit 4, pika 3 të vendimit nr. 40/2017 “Për procedurat parlamentare për funksionimin e komisioneve ad hoc dhe realizimin e procesit të votimit, sipas ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e kryetarit të grupit parlamentar të Partisë Socialiste dhe kryetarit të grupit parlamentar të Partisë “Lëvizja Socialiste për Integrim”,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Deputetët Silva Caka (LSI) dhe Dashamir Peza (PS) caktohen anëtarë zëvendësues në përbërje të Komisionit Parlamentar Ad Hoc për verifikimin e kandidatëve për institucionet e rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ngritur me vendimin e Kuvendit nr. 41/2017.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 13.4.2017